



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 298, datë 23.12.2020

**PËR SHPALLJEN E VENDEVE VAKANTE PËR DREJTUES TË PROKURORIVE
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM NËPËRMJET PROCEDURËS SË
NGRITJES NË DETYRË**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 52 pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, gërma “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” miratuar me Vendimin nr.200, datë 23.09.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e 10 (dhjetë) vendeve vakante për Drejtues prokurorie, përmes procedurës së ngritjes në detyrë, në Prokuroritë e mëposhtme

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër
2. Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë
3. Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë
4. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Tropojë
5. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Dibër
6. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Përmet
7. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Gjirokastër
8. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Pukë
9. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Kavajë
10. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Berat

2. Njoftimi i vendeve vakante si dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët do të publikohen në faqen zyrtare të institucionit, jo më vonë se një javë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETARI
GENT IBRAHIMI

ANËTAR

KOSTAQ BELURI

ANËTAR

SANDËR BECI

ANËTAR

BUJAR SHESHI

ANËTAR

VATË STAKA

ANËTAR

ESMERALDA KESHI

ZV/KRYETAR

ALFRED BALLA

ANËTAR

NURIHAN SEITK

ANËTAR

TARTAR BAZAJ